

Të bëhesh klient banke

Për t'u bërë klient në një bankë suedeze, duhet të identifikohesh dhe të përgjigjesh në pyetjet se përse ke nevojë për një llogari banke. Këtu gjen këshilla rreth informacioneve për të cilat ka nevojë banka me rastin e vizitës suaj në një bankë.

Identifikimi

Ti, duhet gjithmonë të identifikohesh.

Nëse të mungon numri personal suedez

1. Ti, duhet të identifikohesh me një dokument suedez identifikimi të vlefshëm, si pasaportë, ID-kartë kombëtare ose ID-bakë. Ti, po ashtu, mund të identifikohesh me një patentë shoferi suedeze.
2. Nëse nuk ke dokument identiteti të vlefshëm, ti mund të identifikohesh me një pasaportë të vlefshme të një shteti tjetër, ose ndonjë dokument tjetër identifikimi të pajisur me fotografi, ku shihet shtetësia juaj. Ai duhet të jetë lëshuar nga një organ zyrtar ose nga një lëshues tjetër përkatës. Vini Re! Banka mund të kërkojë që ti të tregosh edhe dokumente të tjera.
3. Nëse nuk ke dokument identifikimi të vlefshëm, ti duhet me dokumente të tjera, nga një burim i pavarur dhe i besueshëm, të tregosh se kush je ti dhe të tregosh shtetësinë tënde.

Studentët e huaj

Nëse ti je një student nga një shtet tjetër, ke nevojë të identifikohesh, si më lartë. Përveç kësaj, ti duhet të kesh:

- Leje qëndrimi ose vizë (vlen për shtetasit e UE).
- Përgjigjen se je pranuar në universitet ku shihet se sa kohë zgjatë shkollimi.

Nevoja për llogari banke

Ti, duhet të shpjegosh se përse ke nevojë për një llogari banke dhe si do ta përdorësh këtë llogari. Arsye mund të jetë, të fusësh aty rrogën tënde apo ndonjë kompensim tjetër, të paguash qiranë apo të kursesh.

Banka, po ashtu, mund të bën pyetje të tjera, për t'u njohur më shumë me ty si klient.

E drejta për llogari...

Mundësia për të hapur llogari banke, e cila përfshihet nga garancia shtetërore për deponime dhe për shërbime themelore të bankës, në parim është e hapur për të gjithë. Kjo vlen, pavarësisht se çfarë shtetësie ke apo pavarësisht nëse ti ke apo jo numër personal suedez.

...por, në disa raste, banka mund të refuzoj të hapësh llogarinë

Banka nuk guxon të hap llogari nëse:

- Banka nuk mund të të identifikoj në mënyrë të mjaftueshme dhe të sigurt
- Banka vlerëson se informacioni i lënë nga ju rreth arsyes për të hapur llogarinë, nuk është i mjaftueshëm
- Banka duke e hapur llogarinë, bënë shkelje të ndonjë rregulli në ligji ose të ndonjë dispozite. tjetër.

Banka mundet, po ashtu, të refuzoj hapjen e llogarisë, nëse ti më herët ke qenë i pandershëm ndaj bankës.

Ki parasysht se...

- Ti, duhet të kuptosh pyetjet e bankës dhe të përgjigjesh në ato.



- Ti, po ashtu, duhet të kuptosh informacionin që ke marrë nga banka.
- Nëse ke nevojë për dikë që të përkthej, duhet të marrësh një person të tillë, në takimin me bankën.
- Banka do të pyes, nga vijnë paratë.
- Llogaria jote dhe shërbimet e tjera bankare, nuk mund të përdoren nga dikush tjetër pa marrëveshje me bankën, për një gjë të tillë.
- Banka mund të bëjë edhe pyetje të tjera, ose të shtroj kushte të tjera.

Informacione të tjera

Për informata të tjera, drejtohuni bankës tuaj përkatëse.

Informata ka edhe në:

Parlamenti suedez:

Ligji (2017:630) mbi masat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit.

Lexo më shumë në www.riksdagen.se

Inspektorati i financave:

Rregulloret e Inspektoratit të financave rreth masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit.

Lexo më shumë në www.fi.se

Shoqata e bankave suedeze:

Informacion rreth masave të bankës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit.

Lexo më shumë në

www.swedishbankers.se

Agjencia shtetërore e debitit

Informata rreth garancisë së depozitimit

Lexo më shumë në

www.riksdagen.se



Svenska **Bankföreningen**
Swedish Bankers' Association

www.swedishbankers.se